



Udhëzimi 16

Shtator 2016

Prokurimi publik

Prokurimi nga shërbimet

PËRMBAJTJA

- [Prokurimi i shërbimeve në kontekst](#)
- [Kur zbatohet Direktiva e Shërbimeve?](#)
- [Cilat subjekte i nënshtrohen zbatimit të Direktivës së Shërbimeve?](#)
- [Aktivitetet e lidhura](#)
- [Cilat lloje kontratash mbulohen?](#)
- [Kufijtë financiarë të BE-së](#)
- [Procedurat e prokurimit](#)
- [Mjetet e blerjes](#)
- [Përrjashtimet që janë specifike për sektorin e shërbimeve](#)
- [Përrjashtimi i nenit 34](#)
- [Mjetet juridike](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Prokurimi i shërbimeve në kontekst

Termi "shërbimet" është përdorur zakonisht për të përshkruar organizatat që ofrojnë shërbime - të tilla si sigurimi i ujit, energjisë elektrike, gazit apo transportit - për një komunitet si një i tërë zakonisht me anë të rrjeteve fikse. Në shumë shtete anëtare, aktivitetet në sektorin e shërbimeve i janë besuar organizatave qeveritare që janë subjekte publike. Megjithatë, në disa shtete anëtare organet që veprojnë në sektorin e shërbimeve janë ndërmarrje tërësisht private që nuk do janë subjekt i përkufizimit të autoritetit kontraktor për qëllimet e Direktivës së Sektorit Publik¹ (Direktiva). Në shtetet e tjera anëtare, mund të ketë ekonomi të përzier, që do të thotë se subjektet private dhe publike veprojnë në të njëjtat tregje të shërbimeve.

Kjo panoramë e kombinuar krijoi një problem kur autoritetet e Bashkimit Evropian (BE) shqyrtonin rregullimin e aktivitetit të prokurimit në tregun e shërbimeve. Në Shtetet Anëtare ku autoritetet kontraktore operonin në sektorin e shërbimeve, nuk kishte arsye, në parim, pse ato nuk duhej të mbuloheshin nga sistemi i prokurimit publik i krijuar nga direktivat. Megjithatë, ky sistem nuk "mbulonte" kompanitë private, dhe ka pasur disa ngurrime për t'i mbuluar këto kompani në fillim. Autoritetet e BE-së nuk mund të vendosnin rregullat vetëm për shërbimet "publike", sepse kjo do të krijonte një fushë të pabarabartë, e cila do të shtrembërojë konkurrencën, dhe shtetet anëtare nuk ishin të gatshme për të marrë të tilla gjysmë-masa.

Një arsye tjetër për rregullimin e subjekteve që veprojnë në këto sektorë ishte natyra e mbyllur e tregut në disa shtete anëtare, ku ekzistenca ose dhënia e të drejtave të veçanta ose ekskluzive nga shteti do të krijonte një situatë monopoli që do të kufizonte konkurrencën. Konkurrenca është e kufizuar edhe nga fakti se rrjetet fikse janë të shtrenjta për t'u ndërtuar, por janë relativisht të lira për t'u mirëmbajtur dhe për t'u operuar. Këto rrjete mund të kërkojnë edhe të drejtat e kalimit, të zakonisht janë të kushtueshme ose komplekse nga ana administrative për t'u marrë. Kjo situatë krijon një avantazh afatgjatë, monopolist për operatorin i cili vë në funksionim për herë të parë një rrjet të tillë. Në këtë situatë, interesi publik (interesi i të gjithë përdoruesve të shërbimit, në veçanti në lidhje me vlerën e parasë), duhet të mbrohet duke imponuar rregulla të veçanta për atë se si operatorët e shërbimeve (publik ose privat) të organizojnë blerjet e tyre, përveç rregullimeve të tjera që mund të drejtojnë investimet dhe operacionet e tyre.

Në vitin 1990, rregullatori i BE ka krijuar një mjet për zbatimin e rregullave të prokurimit në sektorin e shërbimeve. Ai e bëri këtë në një Direktivë të veçantë të Shërbimeve (Direktiva 90/531/KEE), në të cilën ishte bërë e qartë se nuk ishin vetëm subjektet "publike" që ishin të detyruara që të ndiqnin rregullat e BE-së në lidhje me prokurimin të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të tyre, por edhe ndërmarrjet private që operojnë në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive. Kjo qasje është vazhduar dhe konfirmuar në Direktivën e Shërbimeve 2014.²

Vlerësimi mbizotërues si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat është shkalla në të cilën subjektet kontraktore janë subjekt i ndikimit të shtetit dhe nëse ky ndikim ushtrohet apo jo nëpërmjet kontrollit të drejtpërdrejtë ose ndikimit të tërthortë (p.sh. fuqia e shtetit për të kontrolluar dhënie dhe funksionimin e të drejtave të veçanta ose ekskluzive për ndërmarrjet private). Vlen të përmendet në këtë kontekst se sektori i telekomunikacionit ishte sektor që rregullohej, por liberalizimi i plotë i tregut në fund të viteve 1990 dhe 2000 çoi në vendimin për ta hequr këtë sektor nga rregulloret sipas Direktivës së Shërbimeve 2004³. Përveç kësaj, në bazë të së njëjtës Direktivë të Shërbimeve 2004, eksplorimi për naftë apo gaz ishte një aktivitet i rëndësishëm. Megjithatë, ky sektor është përjashtuar nga Direktiva e Shërbimeve 2014 për shkak se është

¹ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

² Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

³ Direktiva 2004/17/KE mbi koordinimin e procedurave të prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe të shërbimeve postare, 31 mars 2004.

konstatuar se sektori kishte qenë vazhdimisht subjekt i presionit konkurrues dhe, për këtë arsye, disiplina e prokurimit e vendosur nga rregullat e prokurimit të BE-së nuk është më e nevojshme.

Rregullat mbi shërbimet janë miratuar në një direktivë të veçantë për shkak se dispozitat janë më fleksibël se në Direktivën e Sektorit Publik. Është pranuar se subjektet në sektorin e shërbimeve janë duke operuar në një treg më komercial, që do të thotë se edhe pse parimet kryesore të rregullave të prokurimit publik duhet të respektohen, është gjithashtu e nevojshme që të sigurohet njëfarë fleksibiliteti në mënyrë që të merret parasysh realiteti i mjedisit në të cilin ata veprojnë.

Prandaj, Direktiva e Shërbimeve ka përcaktuar në përgjithësi kërkesa më pak të rrepta ndaj enteve prokuruese se sa Direktiva e Sektorit Publik. Shembujt përfshijnë: kufij më të larta financiarë, një gamë të gjerë të opsioneve në drejtim të momentit se kur dhe si të ofrohet mundësia e kontratës, më pak kontroll mbi realizimin e fazave të përzgjedhjes dhe të vlerësimit, si dhe përdorimin e mjeteve më fleksibël të blerjes se sa parashikohen në Direktivën e Sektorit Publik. Këto kërkesa reflektojnë natyrën shumë komerciale të biznesit dhe funksionimin e shërbimeve në shumë shtete anëtare. Zbatohen parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati,⁴ duke përfshirë trajtimin e barabartë dhe transparencën. Duhet të theksohet se, edhe pse Direktiva e Shërbimeve ka rregulla më fleksibël se Direktiva e Sektorit Publik, pak dallime mbeten në mes të dy grupeve të rregullave në krahasim me Direktivat e vitit 2004.

Kur zbatohet Direktiva e Shërbimeve?

Është e rëndësishme të theksohet se Direktiva Shërbimeve zbatohet për kontratat në lidhje me aktivitete të veçanta vetëm në katër sektorë të shërbimeve: uji, energjia, transporti dhe shërbimet postare.

Direktiva e Shërbimeve vlen vetëm (1), kur një ent prokurues është subjekt i përkufizimit të një shërbimi siç përcaktohet në Direktivën e Shërbimeve, dhe (2), atëherë vetëm në atë masë që shërbimi kryen një aktivitet përkatës të përcaktuar në Direktivën e Shërbimeve dhe në lidhje me kontratat e një lloji të caktuar. Kur plotësohen këto kërkesa, Direktiva Shërbimeve zbatohet për lloje të specifikuara të kontratës, kur vlera e kontratës kalon kufirin përkatës financiar të BE-së.

Cilat subjekte i nënshtrohen zbatimit të Direktivës së Shërbimeve?

Fakti nëse një entitet klasifikohet apo jo brenda përkufizimit të një shërbimi ndaj të cilit zbatohet Direktiva e Shërbimeve nuk është i lidhur me faktin nëse një njësi ekonomike është private ose publike në natyrë. Ajo është e lidhur me dy faktorë: nëse njësi ekonomike vepron në një fushë të caktuar të veprimtarisë (një "aktivitet përkatës"), dhe mbi çfarë baze e kryen subjekti këtë veprimtari.

Ekzistojnë tri lloje të subjektit të përcaktuar:

- **Autoritete kontraktore:** Përkufizimi i autoritetit kontraktor është i njëjtë si në Direktivën e Sektorit Publik. Ka dy lloje kryesore të autoritetit kontraktor: "autoritetet publike" dhe "organet që rregullohen nga e drejta publike". Praktika gjyqësore për këtë çështje ka rezultuar në një përkufizim fleksibël. Për më shumë informacion, shih Udhëzimin nr. 3 të SIGMA-s për Prokurimit publik, *Autoritetet Kontraktore*.
- **Ndërmarrjet publike:** Ndërmarrja publike është përkufizuar në Direktivën e Shërbimeve si "çdo ndërmarrje mbi të cilën autoritetet kontraktore mund të ushtrojnë drejtpërdrejt ose

⁴ Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati".

tërthorazi ndikim mbizotërues në bazë të pronësisë së tyre ndaj saj, pjesëmarrjes së tyre financiare në të, apo rregullave të cilat e drejtojnë atë".

- **Subjektet që veprojnë në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive:** Direktiva e Shërbimeve vlen edhe për subjektet që klasifikohen brenda një përkufizimi me tri pjesë. Këto janë subjekte që:
 - Nuk janë autoritete kontraktore ose ndërmarrjeve publike;
 - Ketë si një nga veprimtaritë e tyre ndonjë prej aktiviteteve përkatëse të përshkruara më poshtë;
 - Veprojnë në bazë të "drejtave të veçanta ose ekskluzive" të dhëna nga një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar.

Për këtë qëllim, "të drejtat e veçanta ose ekskluzive" nënkupton të drejtat e dhëna nga një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar me anë të ndonjë dispozite ligjore, rregullatore ose administrative efekti i të cilave është të kufizojë ushtrimin e veprimtarive përkatëse të një ose më shumë subjekteve, dhe që në thelb ndikon në aftësinë e subjekteve të tjera për të kryer një aktivitet të tillë. Megjithatë, të drejtat që janë dhënë me anë të një procedure, në të cilën është siguruar shpallje e mjaftueshme dhe, kur dhënia e këtyre të drejtave është bazuar në kritere objektive, ato nuk përbëjnë të drejta të veçanta ose ekskluzive. Këto procedura përfshijnë:

- Procedurat e prokurimit me ftesë paraprake për konkurrim, në përputhje me Direktivën 2014/24/BE, Direktivën 2009/81/KE, Direktivën 2014/23/BE ose Direktivën 2014/25/BE;
- Procedurat në zbatim të akteve të tjera ligjore të Bashkimit Evropian duke siguruar transparencë të mjaftueshme paraprake për dhënien e autorizimeve në bazë të kriterëve objektive. Këto procedura janë të shënuara, së bashku me aktivitete të lidhura, në Aneksin II të Direktivës së Shërbimeve. Shembujt përfshijnë dhënien e autorizimit për të operuar instalimet e gazit natyror dhe autorizimin ose njoftimin për tenderin e ndërtimit të objekteve të reja të prodhimit të energjisë elektrike.

Cilat janë "aktivitetet e rëndësishme"?

Subjektet kontraktore që klasifikohen brenda përcaktimeve të mësipërme mbulohen nga Direktiva e Shërbimeve, por vetëm në masën që ato kryejnë një "aktivitet të rëndësishëm" dhe vetëm në lidhje me kontratat e dhëna për qëllim të kryerjes së atij aktiviteti.

Në përmbledhje, aktivitetet e rëndësishme janë:

- **Uji:** Aktivitetet që kanë të bëjnë me "furnizimin e ujit të pijshëm" mbulojnë "ofrimin ose operimin e rrjeteve fikse me qëllimin e ofrimit të shërbimeve për publikun në lidhje me prodhimin, transportin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm" apo furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre rrjeteve. Një "rrjet fiks" mund të dallohet nga metodat e tjera të furnizimit, të tilla si shitja e ujit në shishe, të cilat nuk mbulohen nga Direktiva e Shërbimeve.

Kontratat e lidhura me inxhinierinë hidraulike, ujitjen dhe kullimin të tokës si dhe depozitimin ose trajtimin e ujërave të zeza mund të mbulohen, kur ata janë të dhënë nga një subjekt i angazhuar në furnizimin me ujë të pijshëm.

- **Energjia - gazi, ngrohja dhe energjia elektrike:** Aktivitetet e rëndësishme janë ofrimi ose operimi i rrjetit fiks qëllimin e ofrimit të shërbimeve për publikun në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e energjisë elektrike, gazit ose ngrohjes. Gjithashtu, mbulohet edhe furnizimi (prodhimi, shitja me shumicë dhe pakicë) i energjisë elektrike, gazit dhe ngrohjes në rrjete të tilla. Aktivitete të tjera përfshijnë shfrytëzimin e një zone

gjeografike me qëllimin e eksplorimit dhe të nxjerrjes së qymyrit ose të lëndëve të tjera të ngurta djegëse dhe të nxjerrjes së naftës dhe gazit.

- **Shërbimet e transportit:** aktivitetet e rëndësishme janë disa, por jo të gjitha, shërbimet e transportit. Këtu përfshihet shfrytëzimi i një zone gjeografike për ndërtimin e aeroporteve dhe të porteve detare ose të brendshme ose pajisjeve të tjera të terminaleve për transportuesit ajror, detar apo të ujërave të brendshme. Gjithashtu mbulohet edhe operimi i llojeve të veçanta të rrjeteve të transportit që ofrojnë shërbime për publikun – rrjeti hekurudhor, sistemeve automatike, tramvajeve, trolejbusët, autobusët dhe rrjetet e teleferikëve.
- **Shërbimet postare:** Aktivitetet e rëndësishme janë kontrolli, ndarja, drejtimi dhe shpërndarja e dërgesave postare, si dhe shërbime të tjera të përcaktuara, të tilla si shërbimet e menaxhimit të zyrës së postës dhe i postës direkte që nuk asnjë adresë.

Direktiva e Shërbimeve ofron mekanizmin për të bërë dallimin midis situatave të ndryshme, ku kontrata është kontratë "e përzier": për shembull, kur kontrata përfshin disa aktivitete të rëndësishme apo aktivitete të mbuluara si nga Direktiva e Shërbimeve ashtu edhe nga Direktiva e Sektorit Publik.

Vlen të përmendet se, kur një njësi ekonomike që është një ndërmarrje shërbimi që kryen veprimtari që nuk janë "aktivitete të rëndësishme", kontratat e dhëna nga ndërmarrja e shërbimit në këtë kontekst nuk i nënshtrohen Direktivës së Shërbimeve. Për shembull, kur një njësi ekonomike që operon një aeroport dëshiron të japë një kontratë për ndërtimin dhe funksionimin e një hoteli që nuk është i vendosur në vendin ku ndodhet aeroporti, atëherë kontrata nuk do t'i nënshtrohet Direktivës së Shërbimeve. Arsyeja për këtë është se "aktiviteti i rëndësishëm", përkatësisht ndërtimi i aeroportit është i kufizuar gjeografikisht. Në mënyrë të ngjashme, ndërtimi i një rrjeti të transportit që nuk ka për qëllim t'i shërbejë publikut - të tillë si operimi i një linje hekurudhore të mallrave tërësisht brenda një objekti të madh tregtar fabrikash - nuk do të jetë subjekt i Direktivës së Shërbimeve, pasi ai është një shërbim thjesht komercial që nuk është kryhet për të mirën e publikut. Duhet treguar kujdes ekstrem kur përcaktohet nëse në rrethana të veçanta një kontratë të veçantë mbulohet apo jo nga Direktiva e Shërbimeve.

Cilat lloj kontratash mbulohen?

Direktiva e Shërbimeve mbulon tre lloje kryesore të kontratave, për:

- Punët
- Furnizimet
- Shërbimet: të gjitha shërbimet janë të rregulluara në tërësi nëse ato janë "shërbime të regjimit të lehtë" ose i nënshtrohen njërit prej përjashtimeve.

Për më shumë informacion mbi përkufizimin e kontratave të punëve, mallrave, shërbimeve dhe të shërbimeve të regjimit të lehtë shih Udhëzimin nr. 4 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Kontratat që mbulohen nga Direktivat e Prokurimit Publik*.

Cilët janë kufijtë financiarë të BE-së për kontratat që i nënshtrohen Direktivës së Shërbimeve?

Kufijtë përkatës financiar të BE-së janë më të lartë në bazë të Direktivës së Shërbimeve se sa kufijtë që zbatohen për kontratat që mbulohen nga Direktiva e Sektorit Publik. Kufijtë financiarë caktohen për një periudhë prej dy vjetësh. Kufijtë financiarë për periudhën 1 janar 2016 deri më 31 dhjetor 2017 janë 5.225.000 Euro për kontratat e punëve, 418.000 Euro për kontratat e furnizimeve dhe të

shërbimeve dhe 1.000.000 Euro për shërbime sociale dhe shërbime të tjera të veçanta. Për vlerat e përditësuara të kufirit financiar konsultoni faqen e internetit Evropa.⁵

Dispozita më të hollësishme mbulojnë mënyrën në të cilën llogaritet vlera e kontratave për lloje të veçanta të kontratave dhe situata të veçanta. Dispozitat që lidhen me llogaritjen e vlerës së kontratave kanë si qëllim kryesor garantimin se ka një para-vlerësim të vërtetë dhe transparent të vlerës së kontratës që do të jepen dhe se subjekti kontraktor nuk bën përpjekje për të shmangur zbatimin i Direktivës së Shërbimeve, për shembull duke bërë ndarjen e një kërkesë ose një kontrate në paketa ose kontrata më të vogla poshtë kufirit monetar.

Shih gjithashtu edhe Udhëzimin nr. 5 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Të kuptuarit e kufijve financiarë të BE-së*.

Procedurat e prokurimit

Direktiva e Shërbimeve parashikon pesë procedura kryesore të prokurimit:

- Procedura e hapur
- Procedura e kufizuar
- Procedura me negociim me ftesë paraprake për konkurrim
- Dialog konkurrues
- Partneriteti i inovacionit.

Subjektet kontraktore janë të lira të përdorin procedurën e hapur, të kufizuar apo me negociim me ftesë paraprake për konkurrim. Këto opsione kanë qenë të njëjta sipas Direktivës së Shërbimeve 2004. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që subjektet kontraktore të ketë liri që të përdorin procedurën e dialogun konkurrues apo të partneritetit të inovacionit. Në rastet kur lejohet negociimi nuk zbatohen kushte për përdorimin e këtyre procedurave konkurruese. Prandaj, subjektet kontraktore kanë lirinë për të zgjedhur secilën nga pesë procedurat.

Subjektet kontraktore kanë fleksibilitet edhe në drejtim të asaj se si ata bëjnë shpallje - procesi në Direktivën e Shërbimeve është quajtur si "ftesë për konkurrim".

Kur kryejnë një procedurë të hapur, subjektet kontraktore nuk kanë zgjedhje tjetër prandaj duhet të përdorin Njoftimin e Kontratës.

Kur kryejnë një procedurë të kufizuar ose një procedurë me negociim me një ftesë paraprake për konkurrim, subjektet kontraktore mund të zgjedhin të përdorin një nga elementet e mëposhtme:

- Njoftimin specifik të kontratës
- "Njoftimin indikativ periodik" vjetor
- Njoftimin për ekzistencën e një sistemi kualifikimi.

Gjatë zhvillimit të procedurës së dialogut konkurrues ose të partneritetit të inovacionit, subjektet kontraktore kanë dy zgjidhje:

- Njoftimin specifik të kontratës
- Njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi.

Zbatohen afatet kohore ligjore ndërkohë që duhet të përdoret dhe të publikohet dhe Njoftimi i Kontratës në formatin standard në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)*.

⁵ http://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/rules-implementation/index_en.htm#t1

Kryerja e procesit të prokurimit: Dispozitat e Direktivës së Shërbimeve që mbulojnë zhvillimin e procesit të prokurimit në përgjithësi janë më pak të detajuara dhe më pak përshkruese se rregullat që zbatohen në sektorin publik. Për shembull, nuk ka listë shteruese të kriterëve për përzgjedhjen cilësore, përveç subjekteve kontraktore që janë edhe autoritete kontraktore. Ka edhe dispozita që parashikojnë që afati kohor për pranimin e ofertave të vendoset me marrëveshje të përbashkët. Megjithatë, subjektet kontraktore janë të detyruara të respektojnë parimet e përgjithshme për të siguruar trajtimin e barabartë dhe transparencën dhe për të mos shtrembëruar konkurrencën.

Mjetet e blerjes

Subjektet kontraktore kanë një numër mjetesh të blerjes që ato mund të përdorin:

Sistemet e kualifikimit: Sistemi i kualifikimit është unik në Direktivën e Shërbimeve. Ai është një sistem, i shpallur në *GZBE*, sipas të cilit operatorët ekonomikë të interesuar për të hyrë në kontratë me subjektet kontraktore paraqesin kërkesë për t'u regjistruar si ofrues të mundshëm të punëve, mallrave ose shërbimeve të caktuara. Duke përdorur kriteret e paracaktuara dhe të publikuara të kualifikimit, subjekti kontraktor regjistron disa ose të gjitha këta operatorë ekonomik në sistem. Operatorët ekonomikë të regjistruar formojnë një grup për punë, furnizime ose shërbime të caktuara, nga të cilat subjekti kontraktor mund të nxjerrë ata që ftohen për të konkurruar apo për të negociuar për kontratat.

Marrëveshjet kuadër: Marrëveshje kuadër është një marrëveshje që shpallet në *GZBE* sipas së cilës një ose më shumë operatorë ekonomikë caktohen emëruar si pjesëtarë të marrëveshjes kuadër pas dorëzimit dhe vlerësimit të përzgjedhjes së fazës së informacionit dhe ofertave. Marrëveshja kuadër përcakton kushtet që rregullojnë dhënien e kontratave, në veçanti në lidhje me çmimin dhe, aty ku është e rëndësishme, sasinë. Pasi krijohet marrëveshja kuadër nuk ka asnjë detyrim të mëtejshëm për të bërë shpallje në *GZBE* kur kontratat individuale jepen sipas kushteve të marrëveshjes kuadër.

Procesi sipas Direktivës së Shërbimeve është shumë më i lehtë për t'u rregulluar se sa në bazë të Direktivës së Sektorit Publik. Nuk ka dispozita të hollësishme që mbuluar mënyrën se si duhet të strukturoren apo të funksionojnë marrëveshjet kuadër. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër për shërbimet mund të mos kalojë në përgjithësi tetë vite ndërkohë që mund të jetë më e shkurtër. Direktiva e Shërbimeve parashikon se kohëzgjatja mund t'i kalojë tetë vite vetëm "në raste të veçanta të justifikuara sipas rregullave, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër." Për më shumë informacion mbi marrëveshjet kuadër në sektorin publik, shih Udhëzimin nr. 19 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Marrëveshjet kuadër*.

Sistemet dinamike të blerjes: Sistemi dinamik i blerjes është një procedurë tërësisht elektronike për të bërë blerje të zakonshme. Kohëzgjatja maksimale e sistemit nuk është e përcaktuar. Për të emëruar operatorët ekonomikë, të cilët janë të lirë për të bërë kërkesë për t'iu bashkuar sistemit në çdo kohë duke paraqitur kërkesën për pjesëmarrje, përdoret procedura e kufizuar. Kur një subjekt kontraktor dëshiron të japë një kontratë duke përdorur sistemin dinamik të blerjes, ai fton të gjithë pjesëmarrësit e pranuar apo pjesëmarrësit që janë pranuar në kategorinë specifike të punëve, produkteve ose shërbimeve të dorëzojnë ofertë për çdo prokurim të veçantë. Shih gjithashtu Udhëzimin nr. 11 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Mjetet e prokurimit*, dhe Udhëzimin nr. 17 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Prokurimi elektronik*.

Ankandet elektronike: Ankandi elektronik është një proces elektronik që mundëson paraqitjen e çmimeve të reja (të rishikuara drejt uljes) dhe/ose paraqitjen e elementeve të reja të ofertave pasi është ndërmarrë një vlerësim fillestar i plotë i ofertave. Ankandet elektronike zhvillohen në fazën e fundit të procesit të tenderit që është realizuar deri në atë pikë, në përputhje me një nga procedurat standarde të prokurimit të përcaktuara në Direktivën e Shërbimeve. . Shih gjithashtu Udhëzimin nr. 11 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Mjetet e prokurimit*, dhe Udhëzimin nr. 17 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Prokurimi elektronik*.

Konkurset e projektimit: Realizimi i konkurseve të projektimit rregullohet nga dispozita të veçanta. Rregullat e realizimit janë të ngjashme me ato që zbatohen për sektorin publik.

Përfshirjet që janë specifike për sektorin e shërbimeve

Direktiva e Shërbimeve parashikon përjashtime specifike sektoriale në një numër sektorësh të shërbimeve në bazë të vlerësimeve praktike që lidhen me furnizimin ose me shkallën e konkurrencës në këto tregje. Përfshirjet e tilla zbatohen për blerjen e karburantit dhe të energjisë për prodhimin e energjisë dhe për blerjen e ujit për ofrimin e shërbimeve të ujit.

Direktiva e Shërbimeve përmban një numër përjashtimesh që aplikohen në të gjithë sektorin e shërbimeve:

- **Aktivitetet jashtë BE-së:** Direktiva e Shërbimeve nuk zbatohet për kontratat që subjektet kontraktore japin për qëllime që janë të ndryshme nga ndjekja e aktiviteteve të tyre përkatëse apo "për ushtrimin e aktiviteteve të tilla në një vend të tretë, në kushte që nuk përfshijnë përdorimin fizik të një rrjeti ose zone gjeografike brenda Bashkimi Evropian".
- **Filialet e ndërmarrjeve:** Ku "ndërmarrjet" përbëhen nga një numër shoqërisht në pronësi reciproke apo reciprokisht të varur, Direktiva Shërbimeve ofron një përjashtim të veçantë për blerjet e bëra në mes tyre në kushte të caktuara. Ato trajtohen si kontrata "të brendshme", të quajtura si "transaksione brenda grupit".
- **Ndërmarrjet e përbashkëta:** Direktiva e Shërbimeve nuk zbatohet për kontratat që një ndërmarrje e përbashkët, e cila është formuar ekskluzivisht nga një numër subjektësh kontraktore për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve përkatëse, u ka dhënë këtyre subjekteve kontraktore, ose për kontratat që një subjekt kontraktor ka dhënë për një ndërmarrje të tillë e përbashkët, pjesë e cilës është ai është.
- **Blerjet për ri-shitje ose dhënie me qira:** Direktiva e Shërbimeve përjashton nga objekti i saj kontratat që jepen për qëllime të ri-shitjes ose të dhënies me qira palëve të treta. Ky përjashtim ka për qëllim që të mbulojë, për shembull, kontratat për mallrat, kur subjekti kontraktor ka për qëllim të shesë ose të punësojë pajisjet e blera në një treg konkurrues. Këto kontrata do të përjashtohen vetëm nëse subjekti kontraktor nuk gëzon asnjë të drejtë të veçantë ose ekskluzive për të shitur apo për të punësuar subjektin e kontratave të tilla. Subjektet e tjera janë të lira që të shesin ose të japin me qira atë në bazë të të njëjtave kushte si subjekt kontraktor.
- **Kontratat ndërmjet autoriteteve kontraktore:** Kontratat e dhëna nga autoriteti kontraktor ndaj një personi juridik që rregullohet nga e drejta private apo publike janë jashtë fushës së veprimit të Direktivës së Shërbimeve, kur plotësohen kushtet specifike për kontrollin, përqindjen e aktiviteteve, dhe pjesëmarrjen private të kapitalit (identike me përjashtimin e "brendshëm" në bazë të Direktivës. Shih Udhëzimin nr. 39 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Prokurimi i brendshëm*.

Çfarë është përjashtimi i nenit 34?

Në bazë të nenit 34, Komisioni Evropian mund të vendosë një përjashtim në raste të caktuara nga dispozitat e Direktivës së Shërbimeve për subjektet kontraktore. Ky përjashtim zbatohet kur në Shtetin Anëtar në të cilin është kryer veprimtaria përkatëse kjo është e ekspozuar direkt ndaj konkurrencës dhe në një treg në të cilin nuk kufizohet aksesin.

Analiza nëse tregjet janë konkurruese apo jo merr parasysh detyrimisht si situatat faktike ashtu edhe ato ligjore në Shtetin Anëtar në fjalë. Kjo vlerësohet në bazë të rregullit rast pas rasti. Përjashtimet e zakonshme të dhëna në lidhje me aktivitetet në shtetet individuale anëtare përfshijnë prodhimin

dhe furnizimin e energjisë elektrike, kërkimin e naftës dhe gazit, si dhe ofrimin e shërbimeve ekspres dhe të korrierit.

Përfundimi jepet me anë të një vendimi të Komisioni Evropian, i cili inicohet nga kërkesa e një Shteti Anëtar ose një subjekt kontraktor. Procedura për të përcaktuar nëse zbatohet apo jo Neni 34 plotësohet nga një akt zbatues që miratohet nga Komisioni Evropian, i cili mbulon, ndër të tjera, kërkesat e publikimit, zgjatjet e afateve, dhe detajet e kërkesave.

Lista e përjashtimeve të bëra mund të gjendet në faqen e internetit Evropa⁶.

Mjetet juridike

Mjetet juridike janë veprime juridike në dispozicion të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e dhënies së kontratës. Këto mjete bëjnë të mundur që ata të kërkojnë zbatimin e rregullave të prokurimit publik dhe u japin atyre me të drejta në bazë të këtyre rregullave në rastet kur një subjekt kontraktor, me qëllim apo pa qëllim, nuk vepron në përputhje me ligjin.

Direktiva 92/13/KEE,⁷ e ndryshuar nga Direktiva 2007/66/KE⁸ (Direktiva e mjeteve juridike), rregullon mjetet juridike lidhur me procedurat e dhënies së kontratave nga ana e shërbimeve.

Qëllimi i Direktivës së mjeteve juridike është që të mundësojë kundërshtimin e parregullsive që ndodhin në procedurat e dhënies së kontratës dhe në vendimin për dhënie të kontratës dhe korrigjimin sa më shpejtë të atyre që ndodhin. Zbatimi i Direktivës së mjeteve juridike duhet të rezultojë në një rritje të ligjshmërisë dhe transparencës së procedurave të tilla, të rrisë besimin mes bizneseve, dhe të lehtësojë hapjen e tregjeve të kontratës publike lokale ndaj konkurrencës së huaj.

Edhe pse parimet dhe kërkesat themelore zbatohen në të gjitha shtetet anëtare, ato kanë regjime të ndryshme ligjore dhe gjyqësore, dhe, si rezultat, zbatimi i detajuar i Direktivës së mjeteve juridike ndryshon në lidhje me pasqyrimin e rrethanave të veçanta. Megjithatë, të gjitha mjetet juridike kombëtare duhet të jenë:

- Të qarta dhe të drejtpërdrejta, d.m.th., të kuptueshme dhe të lehta për t'u përdorur nga operatorët ekonomikë;
- Të disponueshme për të gjithë operatorët ekonomik që dëshirojnë të marrin pjesë në një procedurë të veçantë për dhënien e kontratës pa diskriminim, sidomos pa diskriminim mbi bazën e kombësisë;
- Efektive në parandalimin apo korrigjimin e rasteve të paligjshmërisë nga ana e operatorëve të tjerë ekonomik dhe/ose autoritetet kontraktore.

Direktiva e mjeteve juridike kërkon që Shtetet Anëtare, në rrethana të veçanta, të parashikojnë një periudhë pritje për ankesat në fazën e dhënies së kontratës, kur operatorët ekonomik që marrin pjesë në procesin e prokurimit njoftohen për vendimin e dhënies së kontratës. Kjo kërkesë ka për qëllim që të sigurojë të drejtën për të kundërshtuar procedurën e dhënies së kontratës para zbatimit të kontratës së prokurimit. Dispozita të tjera përfshijnë detyrimin për njoftimin e dhënies së kontratës dhe disponueshmërinë në raste të caktuara të një sanksion për pavlefshmërinë e një kontrate të lidhur.

⁶ http://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/rules-implementation/exempt-markets/index_en.htm

⁷ Direktiva 92/13/KEE mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, 25 shkurt 1992.

⁸ Direktiva 2007/66/KE që ndryshon Direktivat e Këshillit 89/665/KEE dhe 92/13/KEE në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të shqyrtimit në funksion të dhënies së kontratave publike, 11 dhjetor 2007.

Informacion i mëtejshëm

Botime

SIGMA (2015), *Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik*, Botimet e OECD-së, Paris, <http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e prokurimit publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Autoritete kontraktore*, Udhëzimi 3, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Kontratat që mbulohen nga Direktivat e Prokurimit Publik*, Udhëzimi 4, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Të kuptuarit e kufijve financiarë të BE-së*, Udhëzimi 5, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Mjetet e prokurimit*, Udhëzimi 11, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Prokurimi elektronik*, Udhëzimi 17, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Marrëveshjet kuadër*, Udhëzimi 19, Botimet e OECD-së, Paris

SIGMA (2016), *Prokurimi i brendshëm*, Udhëzimi 39, Botimet e OECD-së, Paris

Burime të tjera

Faqja e internetit e Komisionit për prokurimin mbulon si sektorin publik ashtu edhe shërbimet.

http://ec.europa.eu/internal_market/publicprocurement/index_en.htm